

20191903006

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR THEMELIMIN E AGJENCISË PËR MBËSHTETJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIMIN RURAL

Neni 1

Në Ligjin për themelimin e Agjencisë për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 72/2007, 5/2009, 43/14, 193/15, 39/16 dhe 164/18), neni 19 ndryshohet si vijon:

“Kërkesën për mbështetje financiare e parashtruar për masa të financuara nga Buxheti i Bashkimit Evropian e cila nuk e përmban dokumentacionin e nevojshëm në momentin e parashtrimit të kërkesës, Agjencia do ta refuzojë si të pabazë.

Nëse kërkesa për mbështetje financiare e parashtruar për masa të financuara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut është e pakompletuar, Agjencia e njofton parashtruesin e kërkesës që në afat jo më të shkurtër se tetë ditë nga dita e pranimin të njoftimit ta plotësojë kërkesën me dokumentacionin e nevojshëm.

Nëse kërkesa nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni është e pakuptueshme, Agjencia e njofton parashtruesin e kërkesës që në afat jo më të shkurtër se tetë ditë nga dita e pranimin të njoftimit ta qartësojë kërkesën.

Kërkesën për mbështetje financiare e cila nuk do të jetë e plotësuar përkatësisht qartësuar në afatin e përcaktuar në pajtim me paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, Agjencia do ta hedh poshtë.“

Neni 2

Në nenin 21 paragrafi 6 fjalët: “tre muaj” zëvendësohen me fjalët: “gjashtë muaj”.

Pas paragrafit 6 shtohen katër paragrafë të rinj 7, 8, 9 dhe 10, si vijojnë:

“Për shkak të shkeljes së detyrimeve kontraktuese të marrëveshjeve nga paragrafi 1 i këtij neni, të financuara nga Buxheti i Bashkimit Evropian, Agjencia mund të zbatojë zvogëlim të mbështetjes financiare të miratuar dhe/ose të paguar si vijon:

(1) në rast të parashtrimit të kërkesës për pagesë të mbështetjes financiare deri në 30 ditë pas kalimit të afatit për parashtrim të përcaktuar në marrëveshjet nga paragrafi 1 i këtij neni, mbështetja financiare e cila duhet t’i paguhet kërkuesit zvogëlohet në shumë prej 5%;

(2) në rast të realizimit të investimit deri në 60 ditë pas kalimit të afatit të paraparë në marrëveshjet nga paragrafi 1 i këtij neni, mbështetja financiare e cila duhet të paguhet zvogëlohet në shumë prej 10%;

(3) në rast të mosnjoftimit të Agjencisë për rrethanat e ndryshuara të cilat nuk kanë ndikim thelbësor të realizimit të investimit të konstatuara gjatë kontrollit në terren, mbështetja financiare do të zvogëlohet në shumë prej 10% nga shuma e paguar paraprakisht;

(4) në rast të shkeljes së konstatuar për obligime të pashlyera në lidhje me tatimet, sigurimin shëndetësor, pensional dhe invalidor si dhe obligimet ndaj Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave për kohëzgjatjen e marrëveshjes nga paragrafi 1 i këtij neni, mbështetja financiare do të zvogëlohet në shumë prej 5% nga shuma e paguar paraprakisht;

(5) në rast të mosshënimit të investimit në pajtim me rregullat për shfrytëzim të mjeteve nga instrumenti për ndihmë paraaderuese të Bashkimit Evropian, mbështetja financiare do të zvogëlohet në shumë prej 2% nga shuma e paguar paraprakisht;

(6) në rast të mënjanimin të shenjës nga pika 5) e këtij paragrafi me të cilën ka qenë i shënuar investimi për tërë kohëzgjatjen e marrëveshjes, mbështetja financiare do të zvogëlohet në shumë prej 5% nga shuma e paguar paraprakisht.

Zvogëlimi i mbështetjes financiare do të zbatohet nëse pranuesi nuk i mënjanon shkeljet e konstatuara të detyrimeve kontraktuese të paragrafit 7 të këtij neni, në afat prej 20 ditësh nga dita kur është njoftuar nga Agjencia për shkeljen e konstatuar.

Në rast të shkeljes së përsëritur të detyrimeve kontraktuese nga paragrafit 7 i këtij neni do të zbatohet zvogëlim i mbështetjes financiare në shumë të rritur për dy herë.

Në rast kur zvogëlimi i mbështetjes financiare do ta tejkalojë shumën prej 20% nga mbështetja financiare e miratuar dhe/ose e paguar, Agjencia kryen kthimin e mbështetjes financiare."

Neni 3

Në nenin 22 në alinenë 5 lidhëza "dhe" në fund të alinesë zëvendësohet me presje.

Në alinenë 6 pika në fund të alinesë zëvendësohet me presje.

Pas alinesë 6 shtohen dy aline të reja 7 dhe 8, si vijojnë:

"- zvogëlim të mjeteve financiare për shkak të shkeljes së detyrimeve kontraktuese nga vëllimi më i vogël, dhe

- mënyrë, procedurë dhe kushte për prishje të marrëveshjes."

Neni 4

Në nenin 28 paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

"Agjencia është e detyruar që në faqen e saj të internetit së paku një herë në gjashtë muaj t'i publikojë shfrytëzuesit e mjeteve financiare nga Buxheti i Bashkimit Evropian me emrin, lokacionin dhe lartësinë e mjeteve të paguara, si dhe me natyrën dhe qëllimin e marrëveshjes së ndarë."

Neni 5

Neni 34-a ndryshohet si vijon:

"Gjobë personit juridik në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet shoqërisë së vogël tregtare, kurse gjobë personit juridik në shumë prej 3.000 deri në 6.000 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet shoqërisë tregtare të mesme dhe të madhe, nëse nuk i kthen në afatin e caktuar mjetet e marra në mënyrë të paligjshme (neni 24-a paragrafi 2).

Gjobë në shumë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni."

Neni 6

Në nenin 34-b fjalët: "500 deri në 750" zëvendësohen me fjalët: "150 deri në 250".

Neni 7

Procedurat për kërkesat për mbështetje financiare të filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë në pajtim me Ligjin për themelimin e Agjencisë për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 72/2007, 5/2009, 43/14, 193/15, 39/16 dhe 164/18).

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".